

**REKOMANDIMET NGA KONFERENCA E 6-të NDËRKOMBËTARE
"INSPEKTIMI, AUDITIMI DHE RËNDËSIA E SISTEMEVE INTELIGJENTE NË TRANSPORT"
25 JANAR 2019**

- Është e rëndësishme që viktimat e aksidentit të dinë se ku të gjejnë mbështetje pas aksidentit. Prandaj është me rëndësi që të krijohen qendra për mbështetje pa pagesë dhe mbështetje financiare për Shoqatat e Viktimave; të rishikohet niveli i kompensimit; t'u kërkohet kompanive të sigurimeve që të ofrojnë pagesa të menjëhershme; dhe shkelje të caktuara të trajtohen si vepra penale të paramenduara.
- Masat që do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes së sigurisë rrugore dhe të cilat janë paraparë të aplikohen janë: shkruarja e tiketave në formë elektronike; vendosja e pajisjeve digjitale statike dhe lëvizëse në rrugët nacionale dhe lokale; shtimi i numrit të automjeteve civile për kontrollim të trafikut; gjetja e modaliteteve për përmbarrimin e tiketave të papaguara; web servis për bankat për pagesat e gjobave me evidetim automatik në databazë.
- Institucionet që kanë mandat dhe palët e përfshira në çështjen e sigurisë rrugore duhet sa më shpejtë të marrin masat konkrete për, edukimin e pjesëmarrësve në rrugë; kontrollimin teknik të automjeteve sipas kriterëve të percaktuara; video vëzhgimin dhe vendosjen e radarëve në rrugë.
- Forcimi i sistemeve të dhënave. Të dhënat për fatalitetet dhe lëndimet në trafikun rrugor janë të një rëndësie jetike për monitorimin e trendëve në nivel vendi, përshtatjen e përpjekjeve parandaluese, vlerësimin e progresit dhe krahasimin shkallës së vdekjeve në trafikun rrugor me vdekjet nga shkaqe të tjera.
- Teknologjitë e reja dhe makinat vetë-ngasëse munden dhe do të përmirësojnë dukshëm sigurinë rrugore. Megjithatë, ato nuk janë "plumba të argjendit" që do të parandalojnë të gjitha aksidentet në mënyrë të menjëhershme. Prandaj është e rëndësishme që ende të zbatohet një shumëllojshmëri e gjerë e masave për të bërë të gjitha aspektet e trafikut rrugor më të sigurta.
- Testimi psikometrik është një procedurë vlerësimi e projektuar për të siguruar masa objektive të një ose më shumë karakteristikave psikologjike. Përdorimet e psikometrisë janë: Përmirësimi i përzgjedhjes së kandidatëve, zvogëlimi i kohës për rekrutim dhe shpenzimeve; Zvogëlimi i qarkullimit të stafit; Krijimi i trajnimeve dhe programeve të personalizuara zhvillimore për individët; Zvogëlimi i aksidenteve rrugore, në vendpunishte dhe vend të punës.
- Auditimi i sigurisë rrugore është proces i domosdoshëm i cili duhet të zbatohet në fazat e projektimit dhe ndërtimit dhe të vazhdohet me inspektime periodike, që të evitohen mangësitë e identifikuar me qëllim të rritjes së sigurisë rrugore, në mënyrë që numri i aksidenteve në rrugë të mbahet në minimum.
- Institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për futjen e lëndës mësimore "Siguria në rrugë" në përmbajtjen kurrikulare për shkolla fillore dhe të mesme të ulëta poashtu edhe për shkolla të mesme të larta.
- Ndërtimi i autostradës "Durrës - Prishtinë - Nish" me një segment kalimi nga Medvegja do të kishte një rëndësi të madhe, sepse për shqiptarët në Serbi do të sillte nxitje dhe zhvillim ekonomik.